

AKT THEMELIMI DHE STATUTI

SHOQËRIA “KHES’ Clinique ” SHPK

TIRANË, SHQIPËRI

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
i
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

" KHES Clinique" Sh.p.k

KAPITULLI I
Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1

Data e themelimit dhe emërtimi

1. Sot, më datën 01/09/2025 deklaroj themelimin e shoqërisë "**KHES' Clinique" sh.p.k** (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
2. Themelues të shoqërisë,
 - Znj. Ajlin Sharku, e bija e Lulzimit lindur më 30/07/1999, në qytetin e Tiranës, dhe banuese në Tiranë, adresa: Rruga "Pjeter Bogdani", pallati 20/4, kodi postar 1001, identifikuar me kartë identiteti ID: **J95730044G**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - Znj. Xhesilda Fejzaj, e bija e Perjanit lindur më 09/12/2000, në shtetin e Belgjikës, dhe banuese në Tiranë, adresa: Rruga 'Bilal Sina" , identifikuar me kartë identiteti ID: **K06209039F**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. Emri i shoqërisë është "**KHES' Clinique" sh.p.k.** (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
4. Në të gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:
 - a) Fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk"
 - b) Numri Unik Identifikimit Subjektit (NUIS) të saj
 - c) Adresa e selisë
 - d) Informacion nëse shoqëria do jetë në proces likuidimi ose falimentimi
 - e) Emri tregtar (nëse do ketë)
 - f) Adresa zyrtare e email-it të shoqërisë

Neni 2

Forma Ligjore

1. Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, që këtu e në vijim do quhet ("Ligji i shoqërive").

Neni 3

Selia, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj, në çdo kohë në një adresë ose qytet tjetër të Shqipërisë.
2. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

Objekti

Neni 5

Objekti i Shoqërisë

1. Objekt i aktivitetit të shoqërisë është:
Ofrimi i shërbimeve dhe trajtimeve në fushën e estetikës, dermatologjisë, kozmetikës brenda dhe jashtë vendit. Hapja dhe administrimi i salloneve, qendrave estetike, instituteve të bukurisë, qendrave të trajnimit, reabilitimit dhe institucioneve arsimore private për formim profesional në këto fusha.
Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm që nuk ndalohet me ligj.

Neni 6

Ndryshime

1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut me kusht që veprimtaria e saj të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në RSH.

KAPITULLI III

Kapitali regjistruar; Ortakët; Kuotat

Neni 7

Kapitali regjistruar

1. Kapitali regjistruar i Shoqërisë është 1000,00 (një mijë) Lek dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlerë nominale 1000,00 (një mijë) Lek, të nënshkruara dhe të paguara plotësisht.

Neni 8

Ortakët e shoqërisë dhe Kuotat e tyre

1. Kapitali regjistruar i shoqërisë “KHES’ Clinique” sh.p. k është i zotëruar 100% nga Ortakët e shoqërisë.
2. Ortakët e shoqërisë janë :
 - Znj. Ajlin Sharku, zotërues 50% i 1(një) kuote me vlerë nominale 500,00 (pesëqind) Lek.

- Znj. Xhesilda Fezaj, zotërues 50% i 1(një) kuote me vlerë nominale 500,00 (pesëqind) Lek
3. Ortakët e Shoqërisë gëzojnë përgjegjesi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota.

Neni 9

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Regjistruar

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakëve të shoqërisë, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të shoqërive tregtare.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë, si dhe me përfshirjen e rezervave (nëse ka) ose fitimeve të akumuluar apo kthimit të borxhit në kapital.
3. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet duke emëtuar kuota të reja apo duke rritur vlerën nominale të kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit regjistruar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
4. Zvogëlimi i kapitalit mund të bëhet vetëm duke zvogëluar vlerën nominale të kuotave ekzistuese.
5. Masa e zvogëlimit të kapitalit duhet të jetë e tillë që vlera e kapitalit të ri pas zvogëlimit të mos bjerë nën kufinjtë e kërkesave të kapitalit minimal konform Ligjit të Shoqërive.

Neni 10


Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve të Shoqërisë

1. Ortakët e Shoqërisë zotërojnë 100% të kuotave të Shoqërisë. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Shoqërive të drejtat dhe detyrimet e asamblese së ortakeve në shoqërinë, do të ushtrohen nga secili ortak. Të gjitha vendimet e tyre do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Një vendim i paregjistruar në këtë regjister do të quhet i pavlefshëm.
2. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i kuotave, transferohen tek çdo zotërues i ri për këto kuota.
3. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë;
4. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të saj.

Neni 11

Fitimi dhe transferimi i kuotave

1. Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj
2. Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen ortakëve ekzistues të shoqërisë dhe personave të tretë brenda apo jashtë shoqërise, për aq kohe sa këta të fundit nuk



ndalohen apo kufizohen në këtë të drejtë, nga ndonjë ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në momentin e realizimit të transferimit.

3. Transferimi i kuotave do bëhet në formë shkresore nëpërmjet kontratës përkatëse me akt noterial.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme – Ortakët e shoqërisë

Neni 12

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi drejtues i shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
2. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Shoqërive të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së ortakëve në shoqërinë , do të ushtrohen nga Ortakët e shoqërisë .
3. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara
4. Vendimet e Asamblesë të marra në përputhje me këtë Statut si dhe me Ligjin për Shoqëritë do të jenë të detyrueshme për Shoqërinë.

Neni 13

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë nga:
 - a) Administratorët;
 - b) Ortakët e shoqërisë;

Neni 14

Mënyra e thirrjes së Asamblesë



1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e paraqitura në nenet e mësipërme.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet në selinë e Shoqërisë apo në çdo adresë tjetër të ndonjë qyteti brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj,
4. Administratorët duhet të mbajnë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me kërkesat e Ligjit të Shoqërive.

Neni 15

Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme

1. Ortakët e Shoqërisë mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
3. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KREU V

Administratorët

Neni 16

Caktimi Administratorëve

1. Në përmbushje të parashikimeve të nenit 12, pika 3 (c), emërimi dhe shkarkimi i administratorëve do të bëhet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Shoqëria mund të drejtohet nga një ose disa Administratorë njëkohësisht.
3. Administratorët mund të emërohen për një periudhë ushtrimi funksioni (mandat) jo më të madhe se 5 vite nga data e vendimit të emërimit ose data e paracaktuar në vendimin e emërimit, datë nga ku kjo detyrë merr fuqi ligjore.
4. Mandati i administratorit mund të ripërtërihet dhe nuk parashikohen kufizime në numrin e ripërtëritjeve.
5. Administratori i Shoqërisë në momentin e themelimit të shoqërisë është:
 - Znj. **Xhesilda Fejzaj**, shtetase shqiptare, lindur më 09/12/2000 në shtetin e Belgjikës me Numer Identifikimi: K06209039F, banues në Tiranë, adresa Rruga "Bilal Sina".
6. Afatet e emërimit për administratorët e shoqërisë në momentin e themelimit, Znj. Xhesilda Fejzaj janë respektivisht 5 vite, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi i shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit).

Neni 17

Kompetencat dhe detyrimet e Administratorëve

1. Kompetencat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
2. Administratorët kanë detyrimin të thërrasin asamblenë e përgjithshme në rastet kur:
 - a) nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - d) ortakët e pakicës, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, e kanë kërkuar mbledhjen e asamblesë duke i drejtuar një kërkesë me shkrim ose me postë elektronike administratorit
 3. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme.

Neni 18

Përfaqësimi

1. Për aq kohë sa nuk është parashikuar dhe nuk do parashikohet specifikisht me një nen të veçantë në statut, kompetencat dhe përgjegjësitë për secilin administrator janë të njëjta, dhe të pakufizuara brenda parashikimeve të këtij statuti dhe Ligjit të Shoqërive.
2. Sidoqoftë, administratorët që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë njërin apo disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU VI

Aktiviteti dhe administrimi financiar i Shoqërisë

Neni 19

Viti ekonomiko-financiar

1. Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit Dhjetor të secilit vit.
2. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë. Viti i fundit financiar përfundon në datën e prishjes ose përfundimit të afatit të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë.

Neni 20

Mbajtja e Llogarive

1. Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe i paraqitet organeve tatimore sipas ligjislacionit në fuqi të vitit pasardhës.
2. Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhen Shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë.

Neni 21

Rezultati financiar dhe shpërndarja e fitimeve

1. Rezultati i Shoqërisë përcaktohet në bazë të pasqyrave financiare të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e objektit të saj.
3. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor pas pagimit të tatimeve, mund të tërhiqen nga ortakët i shoqërisë ose mund të kalojnë në fitimet e akumuluar.

Neni 22

Auditimi i Pasqyrave Financiare

1. Nëse legjislacioni përkatës parashikon detyrimin e shoqërisë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare, atëherë Asambleja e Përgjithshme në përmbushje të kompetencave të parashikuara në nenin 12, pika 3 (ç) të statutit, duhet të caktojë një Auditues Ligjor ose Shoqëri Auditimi, për këtë qëllim.
2. Emërimi i Audituesit Ligjor duhet bërë çdo vit dhe për pasqyrat financiare të çdo viti në qoftë se ato do jenë jenë objekt i auditimit ligjor sipas kërkesave të legjislacionit përkatës dhe emërimi duhet bërë publik në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Edhe kur shoqëria nuk ka detyrim ligjor për auditimin e pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme, në mënyrë vullnetare mund të vendosi për auditimin e pasqyrave financiare dhe caktimin e një Audituesi Ligjor ose Shoqërie Auditimi për këtë qëllim.

KREU VII

Ndryshimi i Formes Ligjore dhe Prishja e shoqërisë

Neni 23

Ndryshimi i Formës Ligjore



1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblese së Përgjithshme sipas kompetencave të parashikuara në nenin 12, pika 3 (gj) këtu dhe në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin e RSH.
2. Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat dhe kërkesat ligjore që parashikohen në dispozitat respektive të Legjislacionit në RSH.

Neni 24

Prishja e Shoqërisë

1. Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:
 - a) si pasoje e perfundimit të kohezgjatjes për të cilin ishte themeluar;
 - b) me vendim të Asamblese së Përgjithshme;
 - c) hapje e një procedure falimentimi/likuidimi;
 - d) me vendim gjykate;
 - e) për arsye të tjera të parashikuara nga Ortaket në çdo kohë.
2. Administratori(et) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", ia dërgon vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

Neni 25

Mosmarrëveshjet

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, në rast se palët nuk do arrijnë dakordësinë me vullnetin dhe konsensusin e tyre, atëherë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatave kompetente përkatëse të Republikës së Shqipërisë.


Neni 26

Dispozita përfundimtare

1. Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
2. Ky Statut u redaktua në 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe u miratua në parim nën për nen nga Ortakët e shoqërisë "KHES Clinique" sh.p.k.
3. Ky Statut nënshkruhet nga Ortakët e shoqërisë në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

PËR SHOQËRINË "KHES' CLINIQUE" SHPK ORTAKËT E SHOQËRISË

AJLIN SHARKU



XHESILDA FEJZAJ

